



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 Qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12, 14, 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 Qershor 2008, dhe nenit 9, 17, 20, të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, duke u bazuar në shkresën e MAPL-së, lidhur me rishqyrtimin e ligjshmerisë të 020-321/7 të datës 16.06.2026, në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2026 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME-LOKALEVE AFARISTE TË KOMUNËS NË ZONËN KADASTRALE NË LIPJAN 15NR.462/01-20084 TË DATËS 30.04.2026

Neni 1

Me këtë Vendim ANULOHET, Vendimi 15Nr.462/01-20084 të datës 30.04.2026 paraparak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të komunës në ZK-Lipjan.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

A r s y e t i m

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Statutit të Komunës së Lipjanit si dhe në Shkresën përcjellëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal 020-321/7 të datës 16.06.2026.

Me Shkresën përcjellëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, është kërkuar rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit të lartë cekur, duke kërkuar që prona e paluajtshme e Komunës-njesitë e lokaleve të jenë të regjistruar në regjistrin e aparatit kadastral.

Përkitazi me këtë, konsiderohet e arsyeshme që të bëhet anulimi i Vendimit në terësi, me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të metutjeshme për vendosjen e kësaj çështje, konform rekomandimeve të Ministrisë.

Nga të cekurat më lartë kërkojmë nga Kuvendi i Komunës që me qëllim të përmbushjes së Rekomandimeve të MAPL-së, të bëjë miratimin e këtij Propozim-Vendimi

1Nr. 01-462/01-27327

Datë: 18.06.2026

Kryetari i Komunës

Imri Ahmeti





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erbllin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, Datë: 29.05. 2026 MAPL -VI-020-321
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Donjeta Cakolli, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtim
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin paraprak Nr.15-462/01-20084 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme-lokaleve afariste të komunës në ZK-Lipjan

I miratuar më datë: 30.04.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.05.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.04.2026, ka miratuar Vendimin paraprak Nr.15-462/01-20084 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme-lokaleve afariste të komunës në ZK-Lipjan.

Vendimin paraprak Nr.15-462/01-20084 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme-lokaleve afariste të komunës në ZK-Lipjan, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht me nenin 5, paragrafi 1, nenparagrafi 1.1, të Ligjin Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe me nenin 4, të Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Ligji Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 5, paragrafi 1, nenparagrafi 1.1 (Kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës), si dhe neni 4, i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës përcakton se:

Prona e paluajtshme e komunës për dhënien në shfrytëzim të jetë e regjistruar në regjistrat kadastral të pronës

MAPL, konstaton se vendimi paraprak i dërguar për shqyrtim të ligjshmërisë nga Komuna e Lipjanit përmban dallim në numrin e njësisë kadastrale që aktualisht është i ndryshëm nga numri i evidentuar në certifikatë të pronës.

Andaj, bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Lipjanit duhet të ndërmer veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin, më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.